



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada – Government
Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë
Ministarstvo Industrije, Preduzetništva i Tergovine
Ministry of Industry, Entrepreneurship and Trade

Agjencia për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë (KIESA)

Bazuar në Udhëzimin Administrativ (MTI) nr. 01/2018, Vendimin nr. 5235 datë 15.07.2021 dhe Vendimin nr. 393/01 datë 09.06.2023 me qëllim të zvogëlimit të deficitit tregtar dhe përmirësimit të kapaciteteve prodhuese të ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme (NVM), rritjen e investimeve, rritjes së eksportit, konkurrueshmërisë dhe hapjen e vendeve të reja të punës, Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, përmes Agjencisë për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë (KIESA) shpallë:

Thirrja publike për përkrahje të ndërmarrjeve NMVM-ve për shërbimet e digjitalizimit

Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë (MINT), respektivisht Agjencia për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë (KIESA) në bashkëpunim me projektin “Enabling Income Generation for the Poor”(EnInGeP) nga Bashkëpunimi Austriak për Zhvillim (ADC) dhe zbatuar nga CARE dhe ECIKS do të mbështesin ndërmarrjet në transformim digjital.

Shuma totale e skemës së grantit është 150,000.00€. MINT/KIESA rezervon të drejtën të mos shpërndajë të gjitha mjetet e disponueshme. Grantet do të ndahen për NMVM- të, me një vlerë prej 2,000€ deri në 4,000€ varësisht nga shërbimi digjital i zgjedhur. Çdo tejkallim i kësaj vlere duhet të mbulohet nga vetë ndërmarrjet përfituese.

Në secilin rast Autoriteti Kontraktues (MINT) rezervon të drejtën të mos shpërndajë të gjitha mjetet në dispozicion.

Për të gjitha procedurat e aplikimit dhe dokumentacionin e nevojshëm, MINT / KIESA ka përgatitur udhëzues për aplikant të cilët do t'i gjeni në linkun: <https://mint.rks-gov.net/> dhe <https://kiesa.rks-gov.net/> ndërsa për të aplikuar online kliko këtu: <https://ekosova.rks-gov.net/677>

Thirrja për aplikim është e hapur nga data 04.09.2025 deri më datë 24.09.2025